



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.20/2018

Prishtinë, më 2 maj 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Saranda Bogujevci, Mexhide Mjaku-Topalli, Mirjeta Kalludra, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Frashër Krasniqi dhe Albulena Balaj- Halimaj.

Stafi mbështetës i komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Skënder Reçica-MPMS, Mahir Yaqçillar-MAP, Minire Begaj-MPMS, Merita Syla –IAP, Edona Hajrullahu-IAP, Bujar Kadriu-Shoqata e të Verbërve, Mexhit Foniqi, Shoqata e të Verbërve, Bahri Xhaferi-MPMS, Jusuf Fazliu-i verbër, Halil Kurmeha-Inciativa e të Verbërve, Jasmin Maksuti-Inciativa e të Verbërve, Daut Tishuku-Shoqata e të Verbërve, Bekim Krasniqi, Mirsad Mulla, Kushtrim Xhelili dhe Emine Prekaj-Shoqata e të Verbërve të Kosovës, Norë Shabani-Koha Ditore, Mirjeta Duraku-Kosovapress, Besjana Bajrami-Ekonomia Online.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Raportimi në komision lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 04/L-092 për persona të verbër.
Të ftuar: Skënder Reçica, ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Mahir Yaqçillar, ministër i Administratës Publike dhe Uran Ismaili, ministër i Shëndetësisë.

2. Të ndryshme.

1. Raportimi në Komision lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 04/L-092 për persona të verbër. Të ftuar: Skënder Reçica, ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Mahir Yagcilar, ministër i Administratës Publike dhe Uran Ismaili, ministër i Shëndetësisë.

Kryetarja, tha se për këtë pikë të rendit të ditës e kemi prezent: Skënder Reçicën, ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Mahir Yagcilar, ministër i Administratës Publike, por Uran Ismaili, ministër i Shëndetësisë, nuk ka ardhur, edhe pse nga kabineti i tij kemi pasur konfirmim se do të jetë prezent. Po ashtu, prezent kemi edhe përfaqësuesit e personave të verbër dhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit, për të diskutuar për zbatimin e ligjit për Persona të Verbër.

Skënder Reçica, tha se është këtu për të raportuar për zbatimin e Ligjit për personat e verbër, por edhe për veprimet që jemi duke ndërmarrë në realizimin e të drejtave ligjore të personave me aftësi të kufizuara në përgjithësi. Në kuadër të kompetencave që dalin nga Ligji për personat e verbër, MPMS ka nxjerrë Rregulloren 02/2013 për funksionimin e Komisionit Medikosocial, bazuar në nenin 17.2 të këtij ligji. Ministria e Punës, për vitin 2018, ka paraparë edhe ndryshimin dhe plotësimin e kësaj rregulloreje. Kjo projektregullore ka kaluar konsultimet publike dhe ka mbetur të dërgohet në Ministrinë e Integritimit Evropian për sigurimin e deklaratës dhe në fund edhe miratimin e saj.

Me qëllim të avancimit të kornizës ligjore dhe zbatimit të Strategjisë sektoriale 2018-2021 të MPMS-së, sipas planit të punës së ministrisë dhe qeverisë për 2018, ka paraparë si aktivitet hartimin e koncept-dokumentit për rregullimin e fushës së të drejtave në përfitime dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara, apo siç po quhet, ligji gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara. Ligji për personat me aftësi të kufizuara do të garantojë trajtimin e barabartë të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuara, në pajtim me normat dhe praktikat ndërkombëtare, përmes këtyre politikave synohet të arrihet ngritje e mirëqenies sociale për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, gjithëpërfshirja e llojeve të aftësisë së kufizuar, kategorizimin në tri grupe, bazuar në përqindjen e aftësisë së kufizuar, kompensimin financiar për llojet e aftësisë së kufizuar, që plotëson kushtet sipas kategorizimit dhe sigurimi i asistentëve dhe shërbimeve sociale, bazuar në kategorizim. Sa i përket punësimit të personave me aftësi të kufizuara nuk është e kënaqshme, jo vetëm në sektorin privat, por edhe në atë publik. Sa i përket sektorit publik, Ligji për shërbimin civil është shumë i mangët, nuk parasheh asnjë dispozitë ku ata mund të kenë përparësi në trajtim më të lehtë, por të gjithë trajtohen në mënyrë të barabartë me personat tjerë pavarësisht gjendjes së tyre shëndetësore.

Kryetarja, tha se jemi të interesuar të dimë statistikën rreth punësimit të personave me aftësi të kufizuara dhe veçanërisht për personat e verbër.

Mahir Yagqillar, Ministria e Administratës Publike, në njëfarë mënyre, është duke menaxhuar edhe zbatimin e Ligjit për shërbimin civil. Ky ligj, në mënyrë decisive, nuk e ka qartësuar këtë çështje, po mendojmë ta përfshijmë në Ligjin për shërbimin publik dhe të zyrtarëve publikë dhe të shikojmë si mund të kemi një situatë më të qartë duke u bazuar edhe në ligjin e punës. Sa i përket statistikave në shërbimin civil, nuk ekzistojnë statistika veç e veç, por sipas informatave të cilat i posedojmë, janë 103 persona me aftësi të kufizuar, të punësuar në shërbimin civil.

Bujar Kadriu, tha se nuk jemi të kënaqur me zbatimin e Ligjit për persona të verbër. Po ashtu, tha se sa i përket zbatimit të ligjit për punën, në lidhje me personat me aftësi të kufizuar, mund të themi se është në pikën zero. Ka pasur punësime sporadike, por ato kanë qenë punësime për të cilat janë angazhuar shoqatat ose personat, në mënyrë individuale. Sa i përket Ligjit për persona të verbër, Kuvendi i Kosovës ka nxjerrë rekomandime të qarta për institucionet e Kosovës dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim për zbatimin e këtyre rekomandimeve nga ana e institucioneve. Përveç nenit 7 të Ligjit për persona të verbër, tjerat nene nuk zbatohen. Ai tha se tani i përfaqëson të gjitha organizatat e personave me aftësi të kufizuara, ndërsa konstatoi se i pëlqeu iniciativa e ministrit, që tha se në qershor do të jetë në agjendë koncept-dokumenti gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara dhe e mirëpresim këtë.

Kryetarja paraqiti disa pyetje për ministrat, ndërsa sa i përket disa çështjeve që kanë të bëjnë me ligjin, janë shumë diskutabile, sa i përket implementimit. A keni informata si funksionon Komisioni Medikosocial? Në bazë të ligjit, kanë mandat vetëm një vit, pa të drejtë rizgjedhjeje dhe kemi informata se ky komision është funksional që 5 vite dhe janë kompetentë që të jenë funksional edhe në nivelin lokal, por kjo funksionon vetëm në Prishtinë. Sa herë, në vit, bëhet vlerësimi për këtë komunitet, dhe nëse komisioni ka konstatuar se një person është i verbër, pse duhet pasur rivlerësim për këtë person?

Bahri Xhaferi- Komisioni Medikosocial, derivon nga rregullorja që e parasheh Ligji për personat e verbër dhe e bën vlerësimin, bazuar në ligj dhe ai vlerësim ka afat kohor 3, respektivisht 5 vjet. Përfituesit e këtij kompensimi nuk kanë kurrfarë obligimi të lajmërohen për muaj apo vite, por duhet të bëhet një verifikim i atyre përfituesve, se a janë në jetë. Ligji duhet të jetë më i avancuar. Aty ku ne jemi kompetentë, si ministri, ligji zbatohet qind për qind dhe kudo në botë vlerësimi i këtyre personave nuk ka një afat të përhershëm.

Skënder Reçica, tha se spitalet rajonale nuk e kanë atë mundësi të ofrimit të këtij shërbimi dhe pikërisht kjo është arsyeja që është koncentruar në Prishtinë. Aplikacionet pranohen nëpër qendrat rajonale dhe komunale, ndërsa rastet trajtohen në QKUK. E dimë që nuk është mirë t'i sjellim nga vendet tjera në Prishtinë, andaj për këtë çështje jemi duke biseduar me Ministrinë e Shëndetësisë, për avancimin e këtij shërbimi edhe në qendrat spitalore rajonale.

Kryetarja, tha se qysh e ka kuptuar, Komisioni Medikosocial, me ligj, ka mandat vetëm njëvjeçar dhe ky komision është duke funksionuar edhe sot, dhe me ligj, ministria nuk ka të drejtë t'ia vazhdojë mandatin. Ndërsa, ju keni shkelur ligjin, dhe me çfarë të drejte ia keni vazhduar mandatin këtij komisioni?

Bahri Xhaferi, anëtarët e Komisionit Medikosocial, është e vërtetë që janë prej fillimit të zbatimit të këtij ligji, por ministria ka të drejtën e vazhdimit të mandatit të këtyre njerëzve.

Skënder Reçica, tha se mandati i këtij komisioni, nga ana e ministrisë, vazhdohet çdo vit. Pas marrjes së detyrës e kam gjetur këtë komision me mandat të vazhduar për një vit dhe nuk kam ndërhyrë, pasi ka pasur mandat, por pasi këta ta kryejnë mandatin, natyrisht që do të bëhet komisioni i ri medikosocial.

Saranda Bogujevci, tha se ka mundësi të ndryshme, duhet të bashkëpunoni me Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe të gjinden mënyrat se si mund të realizohet çështja e vlerësimit të personave të verbër nëpër klinika, në komuna, e jo të mundohen dhe të vijnë në Prishtinë, sa herë që ka nevojë për diagnostikim apo të bëhen ekipe mobile dhe të dërgohen atje ku paraqitet nevoja nëpër qendra të mjekësisë familjare, në komuna.

Skënder Reçica, gjendja faktike është kështu, nëpër spitalet rajonale nuk ka mundësi të bëhet, jo pse nuk ka ekipe të specializuara, por jemi duke biseduar me ministrin e Shëndetësisë, nëse mund të pajisen spitalet rajonale, me pajisjet që kërkohen për përcaktimin e nivelit të personave që u nënshtrohen ekzaminimit.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se situata e personave me aftësi të kufizuara, në veçanti, e të verbërve, është e rëndë, duke pasur parasysh se po ballafaqohen me probleme të ndryshme, duke filluar nga infrastruktura. Ne, në vazhdimësi, po flasim për një integrim në Evropë dhe si pjesë e integritit evropian është një standard shoqëror që duhet të plotësohet dhe pjesë e saj duhet të jenë personat me aftësi të kufizuara. Ajo pyeti se sa është buxheti vjetor për personat e verbër, u tha se numri i të punësuarve me aftësi të kufizuara, por sa persona të verbër janë të punësuar në institucione publike?

Të gjithë jemi përgjegjës që rekomandimet e dala nga monitorimi i ligjit nuk kanë gjetur zbatim, por kjo barrë i bie Qeverisë, por si deputet do të angazhohemi maksimalisht dhe do të monitorojmë punën e Qeverisë për të mirën e këtyre personave.

Skënder Reçica, kemi trashëguar një situatë, ku Komisioni Medikosocial, prej vitit 2013 nuk është ndërruar asnjëherë, po përpiqemi t'i sanojmë problemet gradualisht. Disa kriteret që parashihen me aktet nënligjore, shpeshherë është e pamundur të zbatohen ose të arrihen. Si ministri, kemi planifikuar buxhet të mjaftueshëm për mbulimin e kostos për kompensimin mujor t; kategorisë së parë dhe të dytë.

Teuta Haxhiu, a është bërë një llogari se sa do t'i kushtonte spitalit në Gjakovë dhe spitaleve të tjera, buxhet për t'u pajisur me ato pajisje, në mënyrë që mos të enden personat që kanë nevojë diagnostikimi apo vlerësimi. Është mirë që të dihet, sa është ai buxhet që nevojitet, sepse kur e kemi rishikimin e buxhetit, si komision, mund të propozojmë një amendament për të kërkuar që të paktën t'i kemi edhe nja dy qendra të tjera spitalore me ato pajisje. Çka është bërë për ata persona që janë 100% të verbër, por që fëmijët i kanë dëshmorë në luftën e fundit,

a është rregulluar çështja e pensionit? Sepse, u janë shkelur të drejtat më elementare, duke i qitur në lajthitje të zgjedhin pensionin e fëmijës, që ka rënë dëshmor apo kompensimin, apo pensionit që është për shkak të verbërisë. A është bërë një vlerësim, se cilat institucione kanë respektuar Ligjin për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, në çfarë përqindjeje dhe a është bërë një lobim, se ata që punësojnë persona me aftësi të kufizuara, qofshin persona fizikë apo juridikë, përfitojnë benificione të caktuara sipas ligjeve në fuqi?

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se është shqetësuese që rekomandimet që po nxirren nga komisioni po votohen në Kuvend apo ngelin në sirtarë, apo po dërgohen në adresë të duhur, në ministritë përkatëse dhe më pas t'i marrim përgjigjet për zbatim. Është e vërtetë që Kosova ka ligje të hartuara mirë, por është problem se nuk po gjejnë zbatim, pak është i vonuar edhe hartimi i draft-konceptit për projektligjin gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara. Po ashtu, uroj që ai draft-koncept të jetë i hartuar mirë dhe të shndërrohet në ligj, sa më shpejt, në mënyrë që të gjejë zbatim e jo vetëm sa për të qenë. Shumë studentë janë ankuar se nuk gjejnë literaturën e duhur gjatë studimeve dhe Ministria e Arsimit duhet të merret me këtë çështje. Ndërsa, lidhur me Ligjin për aftësim dhe riaftësim, çka keni punuar ju si ministër, pasi që keni marrë detyrën në këtë drejtim dhe më intereson ta di, çka është ndërmarrë për zhdoganim të veturave për personat me aftësi të kufizuara?

Mirjeta Kalludra, u interesua të dijë sa është numri i personave me aftësi të kufizuara dhe i atyre të verbër, si dhe çka ka bërë si ministër në identifikimin e numrit të saktë të personave me aftësi të kufizuara, në këtë rast, te personat e verbër, me qëllim që të kemi një numër të saktë të tyre, që të planifikojmë edhe buxhetin, si dhe të hartojmë politika të mira për ta.

Më tej, ajo ngriti çështjen se a ka bërë Inspektorati i punës inspektim te kompanitë e mëdha, lidhur me zbatimin e ligjit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Duda Balje, tha se ka dijeni se librezat për personat e verbër paguhen 24 euro, dhe a është kjo e vërtetë, ndërsa në nenin 6 të Ligjit për persona të verbër, thuhet se personat e verbër lirohen nga taksat dhe tatimet.

Bujar Kadriu, tha se kjo është e vërtetë, por keni ngatërruar legjislacionin, me nenin 17.8 i jep të drejtën Shoqatës së personave të Verbër të Kosovës për të lëshuar librezën e verbërisë me vendim të Komisionit medikosocial. 2037 librezat kanë dalë prej zyrës së shoqatës së personave të verbër, aktualisht janë 2010 persona fitues nga ligji i personave të verbër, sepse ka persona që kanë vdekur dhe të gjitha evidencat i kemi. Mendoj se kjo nuk është e kundërligjshme. Anëtarësia nuk është as taksë, as tatim, por kjo është një pagesë që të gjitha të hyrat që mbledhen prej atyre taksave ato iu kthehen komunitetit të të verbërve dhe e them me argumente të plota.

Lirije Kajtazi, tha se mangësi e këtij ligji është edhe nenin 17.8 dhe se anëtarësimi dhe kjo taksë është vjetore, që është ngarkesë për këtë kategori dhe e shohim së bashku që është e domosdoshme të intervenohet në këtë çështje, dhe aq më tepër, përfitues është vetëm ai person

që pajiset. Është shumë shqetësues për ne të thuhet se vetëm neni 7 i ligjit gjen zbatim e nenet tjera jo.

Halil Kurmehaj, përmendi disa prej shqetësimeve që ata kanë. Iniciativa e pavarur e të verbërve të Kosovës ka disa kërkesa për Qeverinë, është çështja e mandatit të komisionit medikosocial, që ligji e thotë shumë qartë, është një vit, pa të drejtë rizgjedhjeje dhe ata që sa vite nuk ndërrohen. Çështje tjetër është rivlerësimi, le të thotë dikush se në cilin vend të Evropës bëhet rivlerësimi çdo tri vjet. Pajisja me librezë të verbërisë, është e detyruar ta nxjerrë Shoqata e Personave të Verbër të Kosovës, është shkelje e rëndë. Përse duhet ta lëshojë këtë një OJQ dhe të detyrohen të jenë pjesë e kësaj OJQ-je? Është në rregull të paguhet anëtarësia, por librezat e verbërisë dhe librezat e anëtarësisë janë dy dokumente të ndryshme. Prej janarit të këtij viti nuk është i riezaminuar, vetëm se ka organizuar protesta. Neni 24 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, thotë se të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit. Më thoni, si ka mundësi të lëshohen 2000 vendime, në të njëjtën datë? Tani, 2000 vendimeve iu skadon afati në të njëjtën datë. Kjo ndodh këtu, që nuk ndodhur askund tjetër. Një çështje shumë e rëndësishme, është çështja e punësimit të personave të verbër. Protestat që po organizohen, e që shumë shpjet do të ketë edhe grevë urie, sepse po ndodhin padrejtësi të mëdha. Njerëzit janë shkolluar, kanë kryer studimet e tani nuk mund të gjejnë një vend pune, këtu nuk bëhet fjalë për drejtësi fare. E kam ngritur një çështje disa herë në zyrën ligjore të MPMS-së dhe me është thënë se ne kemi partneritet me shoqatën. Ne nuk jemi duke e ndalur partneritetin. Po ashtu, ne kishim takim edhe në Ministrinë e Administratës Publike, ku kishin deleguar drejtorin e Departamentit të Administratës Civile, dhe kur ne iu bënim pyetje, nuk ishin në gjendje për të marrë asnjë vendim. Lus ministrin Yagcilar, që ata që na i dërgon në takim, mos të jenë persona vetëm sa për t'i takuar, por persona adekuat që marrin përgjegjësi. Unë, tha ai, vij nga Deçani, kemi shpenzime dhe tani edhe pensionin ma kanë ndaluar, jo vetëm mua, por edhe disa të tjerëve. Çështja e punësimit është e rregulluar edhe me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe me Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Kërkojmë që këto ministri të marrin këto obligime: MPMS, të marrë vendim të menjëhershëm që Komisioni Medikosocial, i cili ka bërë shkelje, të shkarkohet menjëherë dhe të formohet komisioni i ri; Librezat e verbërisë t'i lëshojë shteti, siç lëshohen në vendet evropiane. MAPL dhe MPMS, shumë shpejt, të formojnë grupet punuese për hartim të akteve të kuadrit nënligjor, i cili do të rregullojë çështjen e personave me aftësi të kufizuara, rrjedhimisht të verbërve dhe të sanksionojë ato institucione, që bëjnë shkeljen e këtyre normave. Kërkojmë nga deputetët të shtyjnë këto procese përpara dhe që ekzaminimi të fillojë në qendrat rajonale.

Edona Hajrullahu, si IAP, në vazhdimësi jemi në takime me përfaqësuesit e këtyre organizatave, dhe përveç ankesave individuale, që ne pranojmë, hetojmë edhe ankesa që këto organizata i adresojnë te ne. Pra, edhe në raportin vjetor të IAP-it, personat me aftësi të kufizuara, edhe personat e verbër, janë përfshirë në raport. Sa i përket zbatimit të Ligjit për personat e verbër, është konstatuar se gjen zbatim vetëm në dy dispozita.

Janë bërë 6 vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji, e aktet nënligjore nuk janë përfunduar. Shpresoj që vitin e ardhshëm të kemi një ligj gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara dhe të kemi të planifikuar një buxhet, në mënyrë sa më të mirë, që të realizohet zbatimi i atij ligji.

Skënder Reçica, shpresoj se gjithë ky debat këtu është bërë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të kenë një jetë më të dinjitetshme dhe një përkrahje dhe një dorë të shtetit më të fuqishme. Shpreh zotim tim, se e kanë përkrahjen, nuk e di sa do të jetë kostoja që shërbimet ekzaminuese të kryhen nëpër spitalet rajonale. Po ashtu, jam i informuar që nuk kanë mundësi profesionale t'i ofrojnë këto lloje të shërbimeve. Pra, do ta shikoj edhe njëherë këtë, se a ka mundësi, dhe nëse kërkohet diçka nga MPMS, iu premtoj se do ta kryejmë atë shërbim.

Në nëntor të vitit të kaluar kam proceduar në Qeveri, disa plotësim-ndryshime të Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe kam kërkuar që neni 16, nëse nuk jam gabim, që qytetarëve ose personave përfitues të pensionit kontribut-pagues ose edhe të moshës, t'u lejohet, nëse kanë mundësi, të përfitojnë ndonjë pension tjetër nga ligji për kategoritë e dala nga lufta. Ky plotësim-ndryshim ende nuk ka kaluar në Qeveri dhe pres që së shpejti do ta kemi, por kjo çështje nuk mbaron këtu. Pikërisht, për këtë, ne kemi kërkuar dhe kemi iniciuar reformën e sistemit pensional, me të cilën vetëm atëherë do të mund të rrimë të qetë, se nuk i kemi hyrë në hak asnjë kategorie. U fol shumë për Komisionin Medikosocial. Tani e kemi një rregullore të re, për këtë komision, ku thuhet saktë edhe mandati i këtij komisioni. Kjo rregullore ka kaluar nëpër dëgjimin publik dhe pas rekomandimeve që do t'i marrim nga Ministria e Integritetit do të procedohet në Qeveri. U përmendën rekomandimet e Kuvendit, e sidomos për punësimin, jemi duke u ballafaquar me situatën, ku historikun nuk e kanë në 7 muajt e fundit dhe ne u nënshtrohemi agjendave legjislative, ndërsa me rekomandimet që kanë të bëjnë me kompensimin, ne si Ministri e Punës, jemi duke e zbatuar ligjin, kemi 1798 persona të verbër që i kemi paguar në muajin prill të këtij viti.

Mahir Yagqillar, tha se pyetjen për respektimin e Ligjit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara duhet bërë të gjitha institucioneve, përfshirë edhe IAP. Ligji gjithëpërfshirës, që do të bëhet, duhet caktuar obligimet, kompetencat edhe përfitimet për këta persona dhe pastaj të bëhet edhe kalkulimi real nga aspekti financiar dhe nga aspekti teknik. Kur të bëhen këto, atëherë shumë më lehtë mund të bëhet edhe zbatimi i ligjit. Si Ministri e Administratës Publike, gjithmonë jemi bazuar edhe në ligjet themelore. Në këtë aspekt, Ligji i shërbimit civil është miratuar në vitin 2010 dhe besojmë që në pakon e re të këtyre ligjeve do të marrim parasysh të gjitha parimet e përgjithshme e pastaj për zbatimin nevojitet gjithëpërfshirje. Nga ana tjetër, në zbatim është Ligji për procedurën e përgjithshme administrative, ku mundësohet prapë edhe njerëzit të marrin shërbime, por edhe shteti të ketë obligime ndaj kërkuesve të shërbimeve, kështu që edhe institucionet duhet ta zbatojnë, por edhe njerëzit t'i shfrytëzojnë këto mundësi, sepse janë parime, duke u zbatuar në Kushtetutë dhe standardet evropiane. Sa i përket statistikave, nuk është situata si duhet. Sa i përket infrastrukturës për qasje të personave me aftësi të kufizuara në institucionet publike, në ato ndërtesa ku bëhet projekti i ri, situata

është e lehtë, por në ato ndërtesa ku bëhen modifikime, nuk është lehtë të krijojmë të gjitha ato mundësi për njerëzit me aftësi të kufizuara.

Mexhid Foniqi, propozoi që, kur të ftohet në takimin tjetër të tillë, të jenë prezentë ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, ministri i Arsimit, ministri i Shëndetësisë, ministri i Administratës Publike dhe ministri i Kulturës, në mënyrë që komuniteti i të verbërve të përfitojë sipas ligjit.

Kryetarja, tha se mund të konstatojmë se sa i përket zbatimit të Ligjit për persona të verbër kemi problem me punësim, komisionin medikosocial dhe me lëshimin e librezave dhe besoj se kemi vullnetin, së bashku edhe me ministrin Reçica, shumë shpejt do t'i zgjidhim këto probleme.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje